

ANEKSI nr.1 Raporti Përmbledhës i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit Buxhetor

në/lekë

Emri i Grupit	Instituti i Studimeve te Krimeve te Komunizmit	Kodi i grupit 92											
		Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit											
		Viti paraardhës 2024		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Ndryshimi Vjetor (Plan - Fakt)	% e realizimit
		Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve në %	Planit Fillëtar Vjetor Viti 2025	Struktura e shpenzimeve në %	Planit Vjetor i Rialikuar Viti 2025	Struktura e shpenzimeve në %	Ndryshimi i planit vjetor	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progresive	Struktura e shpenzimeve në %			
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	7 (5-3)	(8)	(9)	10 (5-8)	11 (8/5)			
Shpenzimet sipas programeve buxhetore													
Kodi i Programit	Emërtimi												
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	52,696,619.00	100	58,810,000.00	100	58,910,000.00	100	100,000.00	49,772,501.00	100	9,137,499.00	0.84	
Totali i Shpenzimeve buxhetore te Ministrise (Kap 01,02,03,04,05,08,22)		52,696,619.00	100.00	58,810,000.00	100.00	58,910,000.00	100.00	100,000.00	49,772,501.00	100.00	9,137,499.00	0.84	
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit (Kap 06)		0.00		0.00		0.00		0.00	0.00				
Totali Shpenzimeve te Ministrise		52,696,619.00	100.00	58,810,000.00	100.00	58,910,000.00	100.00	100,000.00	49,772,501.00	100.00	9,137,499.00	0.84	
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik													
Artikulli	Emërtimi												
600	Paga	31,567,474.00	60	36,570,000.00	63	36,570,000.00	63	0.00	30,607,611.00	62	5,962,389.00	83.7	
601	Sigurime Shoqërore	5,008,564.00	10	5,400,000.00	9	5,400,000.00	9	0.00	4,871,726.00	10	528,272.00	90.2	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	15,794,909.00	30	15,720,000.00	27	15,720,000.00	27	0.00	14,196,762.00	29	1,520,238.00	90.3	
603	Subvencione	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00	0.0	
604	Transferita Korrente të Brendshme	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00	0.0	
605	Transferita Korrente të Huaja	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00	0.0	
606	Transa per Buxh. Fam. & Individ	132,152.00	0	120,000.00	0	220,000.00	0	100,000.00	0.00	0	220,000.00	0.0	
Non-Totali Shpenzime Korrente		52,523,099.00	100.00	57,810,000.00	99.84	57,910,000.00	100.00	100,000.00	49,679,101.00	100	8,230,699.00	88.08	
230	Kapitale të Patrupëzuara	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00	0.0	
231	Kapitale të Trupëzuara	173,520.00	100	1,000,000.00	2	1,000,000.00	2	0.00	93,400.00	0	906,600.00	9.3	
Non-Totali Shpenzime Kapitalë me financim të brendshëm		173,520.00	1	1,000,000.00	2	1,000,000.00	2	0.00	93,400.00	0	906,600.00	9.3	
230	Kapitale të Patrupëzuara	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00	0.0	
231	Kapitale të Trupëzuara	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00	0.0	
Non-Totali Shpenzime Kapitalë me financim të huaj		0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00	0.0	
Totali Shpenzime Kapitalë		173,520.00	1	1,000,000.00	2	1,000,000.00	2	0.00	93,400.00	0	906,600.00	9.3	
Totali i Shpenz. Buxhetore te Ministrise/Institucionit Buxhetor		52,696,619.00	100	58,810,000.00	100	58,910,000.00	100	100,000.00	49,772,501.00	100	9,137,499.00	84.5	
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit (Kap 06)		0.00							0.00				
Totali (Korrente + Kapitalë + Shpenz. nga te ardh. jashte limitit)		52,696,619.00							49,772,501.00				
Numri i punonjësve		0		0		0			0				

Sekretari i Përgjithshëm

Emri _____
 Firma _____
 Data _____





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT

Nr. 9/2 Prot

Tiranë, më 16/02/2026

ANALIZA E RAPORTIT TË MONITORIMIT PËR VITIN 2025 HYRJE

ISKK ka kryer monitorimin e buxhetit për periudhën Janar – Dhjetor 2025, nëpërmjet analizës së performancës së fondeve buxhetore dhe krahasimit të treguesve faktikë të realizimit me treguesit e miratuar në planin vjetor. Ky raport monitorimi evidenton nivelin e realizimit të fondeve buxhetore të ISKK-së, të detajuara në nivel kategorie shpenzimi, kundrejt planifikimit të miratuar, duke mundësuar një analizë të qartë të devijimeve, identifikimin e shkaqeve dhe nxjerrjen e konkluzioneve për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit financiar.

Strukturat përkatëse të ISKK-së kanë ndjekur në mënyrë periodike treguesit buxhetorë, me qëllim garantimin e përputhshmërisë së realizimit financiar me objektivat e përcaktuara në Deklaratën e Politikës së Programit, si dhe sigurimin e përdorimit efektiv, ekonomik dhe me eficiencë të fondeve publike.

Në mbështetje të Ligjit nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, si dhe në zbatim të Udhëzimit nr. 9, datë 20.07.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, dhe Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, performanca e realizimit të buxhetit për periudhën Janar – Dhjetor 2025 paraqitet si më poshtë:

PROGRAMI 01110 “PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI”

Buxheti i akorduar për programin “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi” mbështetet në Deklaratën e Politikës së Programit të hartuar në kuadër të PBA 2025–2027 dhe është në funksion të realizimit të objektivave strategjike të institucionit. Politika buxhetore e ISKK-së për vitin 2025 ka synuar përmbushjen në kohë dhe me standard profesional të detyrimeve ligjore dhe funksionale, duke garantuar administrim të qëndrueshëm financiar.

“RAPORTI I SHPENZIMEVE FAKTIKE TË PROGRAMIT SIPAS ARTIKUJVE PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2025”

Në zbatim të Ligjit nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, është bërë çelja dhe administrimi i fondeve buxhetore për vitin 2025 për ISKK-në në vlerën totale 58,910 mijë lekë.

Fondet e alokuara për funksionimin e aktivitetit të ISKK-së sipas zërave buxhetorë për vitin 2025 paraqiten si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr	Emërtimi	Plan vjetor 2025	Plani rishikuar 2025	Fakt mujori 12	Në %
1	Shpenzime për Paga	36,570,000	36,570,000	30,607,611	84%
2	Sigurime shoqërore	5,400,000	5,400,000	4,871,728	90%
3	Mallra e Shërbime	15,840,000	15,840,000	14,199,762	90%
4	Shpenzime për Investime	1,000,000	1,000,000	93,400	9%
	Totali i Shpenzimeve	58,810,000	58,910,000	49,772,501	84.5%

Totali i shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezulton në vlerën 49,772,501 lekë, ose 84.5% e planit të rishikuar vjetor.

ANALIZA E REALIZIMIT TË BUXHETIT TË ISKK-SË PËR PERIUdhËN

JANAR – DHJETOR 2025

Bazuar në Ligjin nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, ISKK për vitin 2025 ka pasur fond të miratuar në total 58,910 mijë lekë, të shpërndarë si vijon: 36,570 mijë lekë për paga, 5,400 mijë lekë për sigurime shoqërore e shëndetësore, 15,840 mijë lekë për shpenzime korente dhe 1,000 mijë lekë për shpenzime kapitale me financim të brendshëm.

Gjatë vitit 2025 është kryer një rishikim buxheti, konkretisht:

– Shtesë fondesh sipas shkresës nr. 2511 Prot., datë 05.02.2025, në zërin 606 “Fond i Veçantë”, në shumën 100,000 lekë.

Në fund të vitit buxhetor 2025, fondet e akorduara nga buxheti i shtetit ishin 58,910,000 lekë, ndërsa realizimi faktik i shpenzimeve arriti në 49,772,501 lekë, ose 84.5% e planit vjetor.

Struktura e realizimit paraqitet si vijon:

- Pagat: 30,607,611 lekë (84%)
- Sigurime shoqërore/shëndetësore: 4,871,728 lekë (90%)
- Shpenzime korente: 14,199,762 lekë (90%)

- Shpenzime kapitale: 93,400 lekë (9%)

1- Paga, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore. Llogaria 600-601.

Fondi i alokuar për vitin 2025 për zërin "Paga dhe Sigurime" është në vlerën 41,970 mijë lekë, me një organikë të miratuar prej 22 punonjësish.

Realizimi në masën 84.5%, në vlerën 35,749 mijë lekë, ka ardhur si rezultat i mosplotësimit të plotë të strukturës organike gjatë vitit 2025. Konkretisht, janë krijuar vende vakante si pasojë e dorëheqjeve të nëpunësve të nivelit të mesëm dhe të lartë drejtues, si dhe për shkak të lejeve të lindjes. Në total, struktura ka rezultuar e paplotësuar për 3 pozicione gjatë një pjese të konsiderueshme të vitit buxhetor, duke ndikuar drejtpërdrejt në nivelin e realizimit të fondit të pagave.

2- Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera. Llogaria 602.

Fondi i alokuar për shpenzime operative është 15,840 mijë lekë (27% e totalit të buxhetit). Me shtesën prej 100,000 lekë, plani i rishikuar arriti në 15,940 mijë lekë.

Realizimi faktik është 14,199 mijë lekë, ose 90.3% e planit të rishikuar.

Ky zë ka mbuluar shpenzimet administrative dhe operative të institucionit, përfshirë: shërbimin e sigurisë, energjinë elektrike, ujë, telefoninë, udhëtimet dhe dietat brenda dhe jashtë vendit, botimin e kolanës së librave për vitin 2025, pagesat e autorëve të jashtëm dhe të revistës, shpenzimet e faqesjes së 10 librave, si dhe organizimin e aktiviteteve shkencore dhe promovuese (konferenca, seminare, ekspozita).

Mosrealizimi i buxhetit gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025 konstatohet mosrealizim i pjesshëm i buxhetit në disa zëra, për arsyt si më poshtë:

Paga dhe sigurime shoqërore

Mosrealizimi i fondit prej 6,221 mijë lekë lidhet drejtpërdrejt me mosplotësimin e vendeve vakante gjatë vitit 2025, si pasojë e dorëheqjeve dhe mungesave afatgjata si lejet e lindjes.

Mallra dhe shërbime

Mosrealizimi në vlerën 1,520,238 lekë ka ardhur si rezultat i mosrealizimit të procedurës së prokurimit me objekt "Shtypshkrimi i librave të kolanës për vitin 2025", për shkaqe objektive jashtë vullnetit të ISKK-së.

Shpenzime kapitale

Nga fondi i planifikuar 1,000,000 lekë, janë realizuar 93,400 lekë, duke rezultuar një mospërdorim prej 906,600 lekë. Kjo situatë lidhet me mosrikthimin e ISKK-së në ambientet e restauruara të godinës, çka pamundësoi realizimin e investimeve të planifikuara për mobilim dhe pajisje.

Procedurat e parealizuara gjatë vitit 2025 përfshijnë:

- “Blerje pajisje zyre” – 600,000 lekë
- “Blerje pajisje kompjuterike” – 300,000 lekë

Mosrealizimi lidhet me procesin e restaurimit të godinës së ISKK-së në kuadër të Programit EU4Culture, sipas shkresës nr. 1762 prot., datë 29.03.2022 të Ministrisë së Kulturës. Pavarësisht përfundimit të restaurimit, ISKK nuk ka mundur të rikthehet në ambientet përkatëse për arsye që nuk varen nga institucioni, duke ndikuar drejtpërdrejt në realizimin e investimeve kapitale.

Në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ISKK ka vepruar në përputhje me kuadrin ligjor, por procedura e prokurimit për “Shtypshkrimin e kolanës së librave për vitin 2025” nuk është realizuar për shkaqe objektive dhe të dokumentuara.

Nëpunësi Zbatues

Zoica Graçi

